

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Kam kënaqësinë që sot po lancojmë fillimin e Javës Ndërkombëtare të Parasë në Kosovë, të cilën BQK-ja tani më për çdo vit e shënon përmes aktiviteteve të ndryshme, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë në rritjen e edukimit financiar të publikut. Motoja e Javës Ndërkombëtare të Parasë në Kosovë për këtë vit është “Të mësojmë si të fitojmë dhe kursejmë më shumë” që në thelb të saj përmban rëndësinë që ka menaxhimi i adekuat i parasë nga individët për të sjellë më shumë fitime dhe kursime të cilat, rrjedhimisht, çojnë në zhvillim më të madh ekonomik dhe mirëqenie më të madhe për të gjithë qytetarët.

Aktivitetet e lidhura me Javën Ndërkombëtare të Parasë janë një kurorëzim i aktiviteteve të edukimit financiar të cilat BQK-ja i zhvillon përgjatë tërë vitit me një fokus të veçantë te fëmijët dhe te të rinjtë. Edukimi financiar kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen e njohurive të qytetarëve lidhur me menaxhimin e parasë, si dhe mundësive që i ofron sistemi financiar i vendit, duke ndikuar kështu aftësimin e tyre për të marrë vendime më të arsyeshme financiare dhe ekonomike. E tërë kjo kontribuon në një sistem financiar më stabil, i cili është edhe objektivi primar i BQK-së.

Për më tepër, edukimi financiar çdo ditë e më tepër po vlerësohet edhe si vegël shumë e rëndësishme për të ndikuar në zvogëlimin e pabarazisë ekonomike. Prandaj, përveç se në aspektin ekonomik, edukimi financiar është i një rëndësie të madhe edhe për nga aspekti social.

Aktivitetet e Javës Ndërkombëtare të Parasë për vitin 2018 do t'i fillojmë pikërisht me fëmijët, me ç'rast në Qendrën për Trajnim dhe Edukim Financiar të BQK-së do të organizohet aktivitete të ndryshme të cilat për qëllim kanë promovimin e kulturës së kursimit te fëmijët.

Faza e dytë e këtij organizimi i adresohet studentëve të universiteteve të ndryshme në Kosovë, të cilët do të kenë rastin të ndjekim prezantime dhe të bashkëbisedojnë me përfaqësues të menaxhmentit të lartë të BQK-së lidhur me tema aktuale rreth zhvillimeve në sistemin financiar të vendit.

Faza e tretë e Javës Ndërkombëtare të Parasë po ashtu i dedikohet studentëve të universiteteve që operojnë në Kosovë, të cilët ftohen të marrin pjesë në konkursin për video nga fusha e edukimit financiar, i cili ka për qëllim promovimin e edukimit financiar dhe gjetjen e mënyrave më atraktive për të shpërndarë informacionet e edukimit financiar te publiku.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të rregullta për promovimin e edukimit financiar, kam kënaqësinë të ju njoftoj se që nga kjo javë BQK-ja do të lansoj portalin e “edukimit financiar” në kuadër të faqes së internetit të BQK-së, ku qytetarët do të mund të qasen në materiale të ndryshme rreth kësaj fushe.

Kur flasim për paranë dhe kursimet, nuk mund të mos flasim edhe për institucionet bankare, të cilat kanë një rol shumë të rëndësishëm për të mobilizuar kursimet dhe për t’i kanalizuar ato drejtë përdorimeve më produktive. Prandaj, me këtë rast, më lejoni që t’ju paraqes një pasqyrë të shkurtër të zhvillimeve kryesore që kanë karakterizuar sistemin bankar të vendit gjatë periudhës së fundit.

Aktiviteti kredihënës i sektorit bankar të vendit vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit që lamë pas, duke shërbyer kështu si njëri ndër financuesit kryesorë të ekonomisë së vendit. Gjithsej vlera e kredive të sektorit bankar në vitin 2017 arriti në 2.48 miliard euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.5 përqind. Rritja e qëndrueshme e kreditimit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit të cilat arritën vlerën prej 3.1 miliard euro dhe

shënuan një rritje prej 6.7 përqind në krahasim me vitin paraprak. Rritja e vazhdueshme e depozitave në sektorin bankar tregon për potencialin që ka ekonomia e vendit për të gjeneruar kursime dhe, në të njëjtën kohë, konfirmon besimin e qytetarëve në sektorin bankar të Kosovës.

Kreditimi bankar, përveç se u karakterizua me rritje të qëndrueshme, në vazhdimësi regjistroi edhe përmirësim të kushteve të financimit për bizneset dhe ekonomitë familjare, duke e fuqizuar kështu edhe më tutje rolin e tij në financimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Me këtë rast, dëshiroj të potencoj rënien e theksuar të normave të interesit në kreditë bankare, të cilat tani më kanë zbritur në nivelin e mesatares së rajonit, duke nxitur kështu kërkesën për kredi dhe duke mundësuar realizimin e shumë projekteve investive të cilat nuk do të mund të ndodhnin pa financim bankar. Në fund të vitit 2017, norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.1 përqind që tregon për rënie të theksuar të normave të interesit

Në frymën e organizimit të Javës Ndërkombëtare të Parasë në Kosovë që në thelb të motos së saj ka kursimin, dëshiroj të potencoj se qëndrueshmëria e sektorit bankar, e cila është esenciale për të inkurajuar kursimin e qytetarëve, gjatë vitit 2018 ka shënuar rritje të mëtejme. Sektori bankar i Kosovës në vazhdimësi ka mirëmbajtur një pozicion të fuqishëm të likuiditetit, që nënkupton aftësinë e bankave për të përmbushur me kohë detyrimet e tyre si dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Norma e likuiditetit të sektorit bankar në vitin 2017 ishte 38.2 përqind e cila është dukshëm mbi minimumin e kërkuar rregullativ. Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të vitit 2017 vazhduar të tejkalojnë kërkesat rregullatorë, me ç'rast gjithsej kapitali në raport me mjetet e peshuara me rrezik qëndrojnë në 18%, ndërsa treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ishte 16.2% krahasuar me kërkesat rregullatorë prej 12% respektivisht 8%.

Po ashtu, cilësia e mirë e portofolit kreditor të sektorit bankar, e cila në vazhdimësi ka shfaqur shëndetin e mirë që gëzon sektori bankar i Kosovës, gjatë vitit 2017 shënoi përmirësim të mëtejshëm të cilësisë. Norma e kredive joperformuese gjatë këtij viti zbriti në 3.1 përqind, nga 8.7% sa ishin në fillim të vitit 2014, e cila shprehur në përqindje paraqet një rënie prej 63.7%. Njëherësh, dëshiroj të theksoj se norma aktuale e kredive performuese paraqet normën më të ulët të shënuar në më tepër se 10 vite në sistemin bankar të Republikës së Kosovës. Shprehur në terma absolutë, vlera e kredive joperformuese nga 154 milionë sa ishin në fillim të vitit 2014, u përgjysmua në 77 milionë në fund të vitit 2017.

Gjatë viteve të fundit, sektori bankar i Kosovës ka shënuar progres të rëndësishëm edhe në digjitalizimin e shërbimeve financiare përmes sjelljes së teknologjive më moderne, të cilat po i ofrojnë qytetarëve dhe bizneseve një qasje më të lehtë dhe më pak të kushtueshme në shërbimet bankare. Viti 2017 ka shënuar rritje të shfrytëzimit të shërbimeve bankare përmes platformave elektronike, gjë e cila ndikon në rritjen e efikasitetit si te bankat ashtu edhe te shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve. Si një shembull i mirë i rritjes së shfrytëzimit të këtyre shërbimeve mund të shërbejë rritja vjetore prej 26.6 përqind e pagesave përmes platformave 'e-banking'. Sidoqoftë, për të rritur efektshmërinë e këtyre shërbimeve, bankat inkurajohen që të vazhdojnë angazhimin e tyre në edukimin financiar të publikut, gjë e cila do të shpejtojë kohën e nevojitur për një depërtim më të shpejtë të këtyre shërbimeve financiare te publiku.

Ngjashëm me sektorin me bankar, zhvillime të favorshme kanë karakterizuar edhe komponentët e tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare po fuqizon çdo ditë e më tepër rolin e tij në financimin e ekonomisë së vendit përmes mikro-kredive, të cilat në vitin 2017 arritën vlerën prej 144.2 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 32.4 përqind.

Sistemi pensional me sukses po arrin të menaxhojë kursimet pensionale të qytetarëve të Kosovës, duke ruajtur dhe duke shtuar vlerën e këtyre kursimeve. Kthimi nga investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2017 ishte 102.6 milionë euro.

Sektori i kompanive të sigurimit, aktiviteti i të cilit bazohet kryesisht në ofrimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm, çdo ditë e më tepër po rritë aktivitetin në fushën e sigurimeve vullnetare të cilat janë shumë të rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut dhe rritjen e aktivitetit në ekonominë e vendit. Gjatë vitit 2018, sektori i sigurimeve në Kosovë, në saje të angazhimit intensiv të BQK-së dhe të kompanive të sigurimit, ka shënuar një progres shumë të rëndësishëm për sa i përket performancës dhe qëndrueshmërisë financiare të këtij sektori, me ç'rast për herë të parë ka arritur të shënojë një rezultat financiar pozitiv me fitim neto prej rreth 6.9 milionë euro. Kjo ka një rëndësi të veçantë për të ardhmen e këtij sektori kur kemi parasysh se ky sektor në vazhdimësi është karakterizuar me brishtësi financiare.

Në përmbyllje, dëshiroj të ju falënderoj për ardhjen dhe të theksoj se interesimi dhe gatishmëria e mediave për të ndjekur dhe për të transmetuar te publiku aktivitetet tona lidhur me Javën Ndërkombëtare të Parasë i bënë ato një partner shumë të rëndësishëm në promovimin e edukimit financiar në Kosovë. Ne mbetemi shumë të përkushtuar që të rrisim aktivitetin tonë në këtë fushë dhe njëkohësisht dëshiroj të ftoj të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë si dhe shoqatat e ndryshme që përfaqësojnë institucionet financiare që t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe edukimit financiar të publikut.